



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.46

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9515 datë 18.4.2006	Për zbatimin e konventës “Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre”..... 1387
Ligj nr.9516 datë 18.4.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar..... 1389
Ligj nr.9517 datë 18.4.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar..... 1390
Ligj nr.9518 datë 18.4.2006	Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit..... 1390
Ligj nr.9519 datë 18.4.2006	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, të ndryshuar..... 1393
Vendim i Kuvendit nr.29, datë 25.4.2006	Për disa ndryshime në përbërjen e komisioneve të përhershme të kuvendit..... 1394
Vendim i Kuvendit nr.30, datë 2.5.2006	Për miratimin e raportit të komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut për ngritjen e komisionit hetimor mbi shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm..... 1394

Vendim i Kuvendit nr.31, datë 2.5.2006	Për ngritjen, caktimin e objektit, të përbërjes dhe të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të prokurorit të përgjithshëm.....	1395
Vendim i Kuvendit nr.32, datë 4.5.2006	Për ngritjen e komisionit hetimor të kuvendit për hetimin e shkarkimeve në administratën publike.....	1396
Vendim i Kuvendit nr.33, datë 4.5.2006	Për ngritjen e komisionit hetimor të kuvendit për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eliminimin e kësaj situate monopol.....	1396
Vendim i Kuvendit nr.34, datë 4.5.2006	Për një shtesë në vendimin e kuvendit nr.31, datë 2.5.2006 “Për ngritjen, caktimin e objektit, të përbërjes dhe të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të prokurorit të përgjithshëm”.....	1397
Rezolutë e Kuvendit datë 4.5.2006	Për vlerësimin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2005.....	1398
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Josif Karaj.....	1398

L I G J
Nr.9515, datë 18.4.2006

PËR ZBATIMIN E KONVENTËS “PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, TË MAGAZINIMIT, TË PRODHIMIT DHE TË TRANSFERIMIT TË MINAVE KUNDËR PERSONIT (MKP) DHE PËR SHKATËRRIMIN E TYRE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 122 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton autoritetin, përgjegjësitë dhe funksionimin e organeve të nevojshme për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga Konventa “Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre” për Republikën e Shqipërisë, si shtet palë në këtë Konventë dhe që më poshtë do të quhet thjesht Konventë.

Neni 2

Kompetencat e autoritetit shtetëror për zbatimin e Konventës

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti shtetëror përgjegjës i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Konventës.

2. Autoriteti shtetëror bashkëpunon me të gjithë organizmat e vendit dhe ata ndërkombëtarë për zbatimin e plotë të Konventës.

3. Autoriteti shtetëror, në rast zbulimi të zonave të minuara ose të dyshuara si të minuara, urdhëron marrjen e masave për sigurimin, rrethimin apo vendosjen e shenjave të dukshme, si dhe njoftimin e paralajmërimit me çdo mënyrë të popullsisë civile në atë zonë.

Neni 3

Detyrimi për deklarimin e veprimtarisë dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror

1. Personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që kryen veprimtarinë e lejuar sipas pikës 2 të nenit 8 të këtij ligji, është i detyruar të paraqesë të dhëna për veprimtarinë që ushtron, nëpërmjet një deklaratë vjetore, sipas formularit që lëshohet nga autoriteti shtetëror.

2. Personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përveç të dhënave, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, është i detyruar të japë çdo të dhënë tjetër për veprimtarinë që ushtron, nëse kjo veprimtari përmban elemente të fushës që mbulon Konventa, sa herë që i kërkohet nga autoriteti shtetëror, për të verifikuar nëse kjo veprimtari është në përputhje me kërkesat e Konventës dhe të këtij ligji.

Neni 4

Inspektimi ndërkombëtar

Inspektimi ndërkombëtar kryhet nga inspektorët e Misionit të Vlerësimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në prani të një grupi shoqërues vendas, i cili kryesohet nga përfaqësuesi i autoritetit shtetëror.

Neni 5

Bashkëpunimi

Subjektet, që zotërojnë ose dyshohet se zotërojnë mina kundër personit, të çdo lloji, janë të detyruara të lejojnë inspektimet dhe të bashkëpunojnë me inspektorët.

Subjektet vënë në dispozicion të ekipit të inspektimit ose të personit të autorizuar:

a) të gjitha të dhënat që u kërkohen për kryerjen e inspektimit;

b) pajisjet e telekomunikacionit, mjediset e punës, mjetet e transportit, të nevojshme për lëvizjet brenda këtyre mjedisëve, për realizimin e inspektimit;

c) dokumentacionin përkatës për pjesët dhe objektet që inspektohen.

Gjithashtu, subjektet detyrohen:

i) të marrin masa sigurimi gjatë kryerjes së inspektimit (për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të inspektorëve);

ii) të kontribuojnë në vlerësimin e rezultateve paraprake të inspektimit dhe në sqarimin e çështjeve të dyshimta.

Neni 6

Kryerja e inspektimeve

Ekipet e Misionit të Vlerësimit të OKB-së në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohen:

a) të hyjnë e të dalin lirisht, gjatë orarit normal të punës, në mjediset ku ndodhet objekti që po inspektohet;

b) të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme për inspektimin dhe të mbledhin të gjitha të dhënat e nevojshme për këtë qëllim, duke marrë në pyetje, kur është e domosdoshme, edhe personelin e objektit që inspektohet;

c) të kontrollojnë dokumentet, materialet, ambalazhimet dhe regjistrat e produkteve që ndodhen në objekt;

ç) të kërkojnë të dhëna për hyrje-daljet e të gjitha mjeteve të transportit, të cilat qarkullojnë në objektin që inspektohet.

Neni 7

Përgjegjësitë e grupit të shoqërimit

Grupi i shoqërimit merr të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një inspektimi efikas dhe të befasishëm, pa cenuar interesat e pronarit ose të drejtuesit të objektit që inspektohet.

Grupi ka këto përgjegjësi:

a) krijon kushtet e nevojshme për inspektim;

b) mbron të dhënat e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si dhe ruan konfidencialitetin;

c) bën klasifikimin e qartë të të gjitha të dhënave, që i vihen në dispozicion ekipit të inspektimit;

ç) merr vendime për vënien e të dhënave konfidenciale në dispozicion të ekipit të inspektorëve, në përputhje me ligjin nr.8457 datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”” dhe me aktet nënligjore në fuqi;

d) zhvillon bisedime me ekipin e inspektimit për ndjekjen e procedurave të veçanta në rastet e parashikuara në pikën 14 të nenit 8 të Konventës.

Neni 8

Veprimtaritë e ndaluara dhe përjashtimet

1. Personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në të gjitha rastet u ndalohet:

a) të zhvillojnë, të prodhojnë, të blejnë, të magazinojnë dhe të zotërojnë mina kundër personit ose t'i transferojnë ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë te persona të tjerë;

b) të përdorin mina kundër personit;

c) të ndihmojnë, të nxisin ose të detyrojnë në çdo mënyrë persona të tjerë që të marrin pjesë në çdo veprimtari të ndaluar për një shtet nënshkrues të Konventës;

ç) të transferojnë ose të marrin nga shtetet, që nuk janë palë në Konventë, mina kundër personit.

2. Përpunimi, transferimi, përdorimi dhe magazinimi i minave kundër personit lejohen nëse veprimtaria ka qëllime:

a) stërvitjeje;

b) pastrimi;

c) teknike, për shkatërrimin e minave.

3. Veprimtaria e lejuar sipas pikës 2 të këtij neni miratohet me urdhër të autoritetit shtetëror.

Neni 9

Kundërvajtjet administrative dhe ekzekutimi i tyre

1. Shmangia nga detyrimet e Konventës dhe nga detyrimet e neneve 3 e 8 të këtij ligji, kur këto veprime nuk përmbajnë elemente të veprave penale, të parashikuara në nenet 278 dhe 278/a të Kodit Penal, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

2. Vënia e gjobave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni bëhet nga organi i kontrollit, krijimi dhe funksionimi i të cilit bëhen me urdhër të autoritetit shtetëror.

3. Subjektet, të cilat gjobiten sipas këtij neni për kundërvajtje administrative, kanë të drejtën e ankimit pranë autoritetit shtetëror, i cili, për shqyrtimin e tyre, krijon një komision të posaçëm.

4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi ndaj vendimeve të autoritetit shtetëror dhe ekzekutimi i gjobës bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7687, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar, me Kodin e Procedurave Administrative dhe me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 10

Nxjerrja e akteve

Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4857, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9516, datë 18.4.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7918, DATË 13.4.1995 “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 “PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)” DHE DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1030, DATË 23.2.1995””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995””, të ndryshuar, fjalë e fundit e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2010.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4858, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9517, datë 18.4.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7943, DATË 1.6.1995 “PËR PENSIONET
SUPLEMENTARE DHE INSTITUTET PRIVATE TË PENSIONEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, pika 5 e nenit 1 “Përkufizime” ndryshohet si më poshtë:

“5. Me termin “Inspektorat” kuptohet një strukturë pranë Ministrisë së Financave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4859, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9518, datë 18.4.2006

PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA PËRDORIMI I ALKOOLIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit.

Neni 2

Objekti i ligjit

Objekti i ligjit është ndalimi i përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit.

Në kuptimin e këtij ligji, pije alkoolike konsiderohen ato pije, që në volumen e tyre kanë përqindje të alkoolit të barabartë ose më të lartë se 1,2 për qind.

Neni 3

Reklama e pijeve alkoolike

Konsiderohet reklamë e pijeve alkoolike çdo formë komunikimi, udhëzimi apo veprimi tregtar i ngjashëm me to dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo ndikon në nxitjen e përdorimit të alkoolit.

Neni 4

Ndalime për përdorimin e alkoolit

Ndalohet shitja ose ofrimi falas i pijeve alkoolike të miturve apo konsumimi i tyre në vende publike nga të miturit.

Në kuptimin e këtij ligji, vendi publik përfshin çdo njësi tregtare, bar, restorant ose klub nate.

Neni 5

Frekuentimi i lokaleve të natës

Përveç rasteve kur është i shoqëruar nga prindi ose kujdestari i tij, një i mitur nuk mund të frekuentojë, nga ora 2200 deri në orën 600, një bar apo lokal nate, në të cilin tregtohet pije alkoolike. Personi që shoqëron të miturin paraqet në hyrje të lokalit dokumentin e identifikimit të vet, si dhe dokumente që vërtetojnë lidhjen e tij si prind ose si kujdestar i të miturit.

Pronarët e lokaleve të natës, në të cilat tregtohen pije alkoolike ose personeli i punësuar nuk lejojnë hyrjen në lokal të personave që nuk janë dukshëm madhorë, pa kërkuar më parë dokumentin e identifikimit.

Neni 6

Dokumenti i identifikimit

1. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, si dokument identifikimi, për të vërtetuar që personi nuk është i mitur, shërben njëri nga këto dokumente:

- a) certifikata e lindjes me fotografi;
- b) pasaporta për udhëtim jashtë shtetit;
- c) dëshmia e aftësisë për drejtim automjete;
- ç) karta e identitetit të nxënësit;
- d) çdo dokument tjetër zyrtar i njëvlefshëm me to.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, si dokument identifikimi, për të vërtetuar lidhjen e personit madhor me të miturin, të cilin ai po shoqëron, shërbejnë:

- a) certifikata e lindjes së të miturit me fotografi, së bashku me dokumentin identifikues të personit madhor, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 1 të këtij neni;
- b) pasaporta për udhëtim jashtë shtetit e të miturit, së bashku me dokumentin identifikues të personit madhor, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 1 të këtij neni.

Neni 7

Detyrimi për kontroll të dokumentit identifikues

1. Subjektet që tregtojnë pije alkoolike në tregje dhe lokale ose personeli i punësuar prej tyre kontrollojnë dokumentin identifikues për personat që nuk janë dukshëm madhorë.

2. Në rast të mungesës së dokumentit identifikues, personat që nuk janë dukshëm madhorë nuk pranohen në lokale nate e nuk u shërbehet në tregje.

3. Subjektet që tregtojnë pije alkoolike janë të detyruar të vendosin në hyrje të lokaleve tabela treguese me shënimin “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç”.

4. Tabela treguese duhet të jetë e dallueshme me një format minimumi A4.

Neni 8

Ndalimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore

Ndalohet përdorimi dhe çdo lloj reklamimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore për të mitur.

Neni 9

Ndalimi i publicitetit për pijet alkoolike në median vizive

1. Ndalohet transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike në brendësi të një programi drejtuar të miturve, si dhe 15 minuta para dhe pas këtij programi.

2. Ndalohet prodhimi dhe transmetimi i publicitetit që përmban skena me të mitur, të cilët konsumojnë pije alkoolike.

Neni 10

Reklamat e pijeve alkoolike

1. Ndalohet çdo formë reklame e pijeve alkoolike që u drejtohet të miturve.

2. Ndalohet çdo reklamë e pijeve alkoolike në sallat e kinemave apo teatrove gjatë shfaqjes për të mitur.

KREU II

MASAT DETYRUESE

Neni 11

Kundërvajtjet administrative

1. Tregtimi nga njësitë tregtare i pijeve alkoolike të miturve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë.

2. Tregtimi apo ofrimi falas i pijeve alkoolike nga baret, restorantet ose klubet e natës të miturve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.

3. Frekuentimi nga të miturit i klubeve të natës, në të cilat tregtohen pije alkoolike, përbën kundërvajtje administrative dhe subjekti dënohet me gjobë nga 30 mijë deri në 50 mijë lekë.

4. Mungesa e tabelave treguese me shënimin “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç” në njësitë tregtare, bare, restorante ose klube nate përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 mijë lekë;

5. Reklamimi drejtpërdrejt ose tërthorazi i pijeve alkoolike drejtuar të miturve në të gjitha mjediset e tjera, përjashtuar ato arsimore, si rrugë, parqe etj., përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 200 mijë lekë.

Neni 12

Dispozita për mediat vizive

1. Transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike në brendësi të një programi drejtuar të miturve, si dhe 15 minuta para dhe pas këtij programi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 200 mijë lekë.

2. Prodhimi dhe transmetimi i publicitetit që përmban skena me të mitur, të cilët konsumojnë pije alkoolike, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 300 mijë lekë.

3. Çdo lloj reklame e pijeve alkoolike në sallat e kinemasë apo teatrove gjatë shfaqjes për të mitur përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 mijë lekë.

KREU III

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

1. Radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet alkoolike.

2. KKRT-ja është organi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji nga personat e licencuar prej tij.

Neni 14

1. Për zbatimin e nenit 11 pikat 1, 2, 3 dhe 4 ngarkohet Inspektorati Sanitar Shëndetësor.

2. Për zbatimin e nenit 11 pika 5 ngarkohet policia bashkiake.
3. Ekzekutimi i gjobave dhe procedura e ankimit ndaj tyre bëhet në bazë të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", të ndryshuar.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4860, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9519, datë 18.4.2006

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8464, DATË 11.3.1999
"PËR STANDARDIZIMIN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit kontrollohet nga Bordi Drejtues. Kriteret e përfaqësimit, numri i anëtarëve dhe rregullorja e funksionimit të Bordit Drejtues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit është institucion qendror publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit është institucion buxhetor, me buxhet më vete.

Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4861, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr.29, datë 25.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Republikane dhe të Grupit Parlamentar “Qendra Demokratë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Parid Teferiçi zgjidhet anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Deputeti Aurel Bylykbashi zgjidhet anëtar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

V E N D I M
Nr.30, datë 2.5.2006

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH PËR NISJEN E
PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 114, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Miratohet Raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për “Ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me kërkesën e një grupi deputetësh për “Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Theodhori Sollaku, në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

V E N D I M
Nr.31, datë 2.5.2006

**PËR NGRITJEN, CAKTIMIN E OBJEKTIT, TË PËRBËRJES DHE TË AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË
GRUPI DEPUTETËSH PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 77 pika 2 dhe 149 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 114 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për “Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Theodhori Sollaku”.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit dhe shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me nenin 149 pika 2 të Kushtetutës, si dhe me nenin 7 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

III. Komisioni përbëhet nga 13 anëtarë, 7 nga shumica parlamentare dhe 6 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

IV. Afati i veprimtarisë së Komisionit është 2 muaj.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

V E N D I M
Nr.32, datë 4.5.2006

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E
SHKARKIMEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e shkarkimeve në administratën publike për periudhën 3 korrik 2005 deri më 31 mars 2006.

II. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor të Kuvendit është:

1. Zbatimi i dispozitave të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të Kodit të Punës për rastet e largimit nga puna të nëpunësve të shërbimit civil dhe të punonjësve të tjerë për periudhën nën hetim.

2. Hetimi i shkaqeve të largimit nga puna të nëpunësve të administratës publike, administratës fiskale dhe asaj doganore.

3. Qëndrimi i mbajtur nga ana e Komisionit të Shërbimit Civil dhe sistemi gjyqësor për rastet e ankimimit të vendimeve të largimit nga puna të nëpunësve me statusin e nëpunësit civil, si dhe rastet e tjera të largimeve kur janë zbatuar dispozitat e Kodit të Punës.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryetari i

Komisionit i takon grupit nismëtar.

IV. Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 3-mujore, duke filluar nga data e miratimit të përbërjes së tij.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të caktojnë mjediset dhe mjetet e punës të Komisionit Hetimor.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

Fatos Beja

V E N D I M

Nr.33, datë 4.5.2006

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E TREGUT MONOPOL TË TELEFONISË CELULARE DHE PËRGATITJEN E REKOMANDIMEVE PËR ELIMINIMIN E KËSAJ SITUATE MONOPOL

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e situatës monopol në fushën e telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

II. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor të Kuvendit është:

1. Hetimi i situatës monopol në fushën e telefonisë celulare dhe vlerësimi ligjor i kushteve që kanë çuar në krijimin e një shtate të tillë.

2. Zbatimi i legjislacionit financiar dhe rregullator në fushën e telefonisë celulare nga ana e operatorëve të licencuar për këtë shërbim.

3. Zbatimi i ligjshmërisë nga ana e institucioneve shtetërore dhe enteve rregullatore përkatëse në fushën e telefonisë celulare dhe nxjerrja e përgjegjësisë, shkaqeve dhe pasojave konkrete të situatës monopol të krijuar.

III. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga opozita. Kryetari i përket opozitës parlamentare.

IV. Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 3-mujore, duke filluar nga data e miratimit të përbërjes së tij.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të caktojnë mjediset dhe mjetet e punës të Komisionit Hetimor.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

Fatos Beja

V E N D I M

Nr.34, datë 4.5.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.31, DATË 2.5.2006 “PËR NGRITJEN, KAKTIMIN E OBJEKTIT, TË PËRBËRJES DHE TË AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e grupeve

parlamentare,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Pas pikës III të vendimit të Kuvendit nr.31, datë 2.5.2006 “Për ngritjen, caktimin e objektit, të përbërjes dhe të afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”, shtohet pika III/1 me këtë përmbajtje:

“III/1. Komisioni Hetimor përbëhet nga:

1. Astrit Patozi	Kryetar	PD
2. Fatmir Xhafa	Zëvendëskryetar	PS
3. Bujar Nishani	anëtar	PD
4. Gazmend Oketa	“	PD
5. Preç Zogaj	“	PD
6. Ardian Kollozi	“	PD
7. Parid Teferiçi	“	PR
8. Flori Bajramaj	“	PAA
9. Arben Isaraj	“	PS
10. Erion Braçe	“	PS
11. Skënder Gjinushi	“	PSD
12. Ndre Legisi	“	LSI
13. Piro Lutaj	“	PAD”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

Fatos Beja

R E Z O L U T Ë

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2005

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe përkrahur veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si një institucion kushtetues, që merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e procesit zgjedhor;
 - duke mbështetur dhe realizuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kuadrin e domosdoshëm ligjor për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike;
 - duke vlerësuar rolin dhe kontributin e të gjitha forcave politike për krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;
- pasi u njoh me Raportin Vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2005, në bazë të nenit 29 pika 9 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9371, datë 14.4.2005 dhe nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

konstatoi se:

- KQZ-ja bëri përpjekje që procesi zgjedhor të administrohej në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, por pothuajse të gjitha afatet e parashikuara në Kod gjatë këtij procesi nuk u arritën të respektohen;
- për shkak të moskrijimit të listave të sakta të zgjedhësve dhe mospërditësimit të tyre nga KQZ-ja, Kuvendi ia kaloi këtë detyrim ekzekutivit, edhe pse administrimi i zgjedhjeve është detyrim kushtetues i KQZ-së;
- veprimtaria monitoruese e KQZ-së për mbikëqyrjen e Kodit Zgjedhor nga media bëri që pasqyrimi i fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore të ishte përgjithësisht i ekuilibruar dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore;
- procesi ishte i tejzgjatur dhe ndonjëherë i pasigurt, për shkak të debateve dhe parregullsive të shumta në disa zona që shkaktoi numërimi i votave;
- në disa raste KQZ-ja ka shfaqur mungesë vullneti për të shfrytëzuar plotësisht kompetencat e veta hetimore, për t’u dhënë një zgjidhje të drejtë ligjore ankesave para dhe paszgjedhore;

Kuvendi kërkon që për vitin 2006 t’u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- të angazhohet maksimalisht për zbatimin e legjislacionit zgjedhor për organizimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të ardhshme vendore;
- të mbajë në qendër të vëmendjes rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, kushteve të punës të komisioneve zgjedhore dhe identifikimin e nevojave logjistike për funksionimin normal të tyre gjatë procesit të ardhshëm zgjedhor;
- të ngrejë në një nivel më të lartë bashkëpunimin me organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- t'u kushtojë më shumë vëmendje komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta, me qëllim aftësimin e tyre profesional mbi bazë trajnimesh të vazhdueshme;
- të njoftojë partitë politike kur merret vendim për kërkesat e tyre për regjistrim;
- KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor nuk duhet të kufizohen pa arsye për llojin e fakteve që mund të marrin në konsideratë gjatë ankimeve zgjedhore;
- të ketë më shumë orientim për veprimet që duhet të marrë në lidhje me kutitë e parregullta të dërguara nga KZZ-ja dhe qartësi më të madhe për rrethanat në të cilat duhet të ndërmarrë një numërim “të parë” të votave, pavarësisht nëse kutitë janë gjykuar të parregullta ose jo;
- të hartojë një axhendë të detajuar për organizimin e zgjedhjeve vendore dhe të kontrollojë zbatimin e kësaj axhende.

Tiranë, më 4.5.2006

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.409, datë 13.4.2006, vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Josif Karaj, i datëlindjes 31.12.1937, lindur në Ersekë dhe banues në Berat.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 11.5.2006
Doli nga shtypi më 15.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë